



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-044

Prishtinë, më 30 tetor 2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 30 TETOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Myfera Shinik.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Dhurata Hoxha dhe Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

1. Konfirmimi i rendit të ditës për seancë plenare, më 2 nëntor 2015,
2. Caktimi i rendit të ditës për seancën plenare, më 6 nëntor 2015.

* * *

1. Konfirmimi i rendit të ditës për seancë plenare, më 2 nëntor 2015

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Qeveria e Kosovës e ka përgatitur Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe gjatë ditës së sotme e procedon në Kuvend për shqyrtim dhe miratim. Gjithashtu, projektligjin duhet ta shqyrtojë Komisioni Funkcional për Integritet Evropian para se të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, e konfirmoi rendin e ditës për seancë plenare, që do të mbahet të hënën, më 2 nëntor 2015, me këtë rend dite:

- 1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njëërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër*

2. Caktimi i rendit të ditës për seancën plenare më 6 nëntor 2015

Kryetari i njoftoi të pranishmit se komisionari i UE-së për Zgjerim gjatë javës së ardhshme do ta vizitojë Kosovën dhe ka shprehur gatishmërinë që me një fjalë rasti t'u drejtohet deputetëve të Kuvendit.

Pas njoftimit të kryetarit, Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të mbajë seancë të veçantë të premtën, më 6 nëntor 2015, me këtë rend dite:

- 1. Adresimi i komisionarit të UE për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatave për Zgjerim, z. Johan Han, deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës*

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale